



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së katërt të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,
mbajtur më 02.07.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit: Ramadan Salihu dhe Jeton Canhasi.

Munguan: Mehreme Llumnica, Armend Ademi, Ermira Shabani dhe Gyltene Retkoceri.

Në mbledhje ishin të pranishëm Prentim Preqi, koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut dhe Irfete Zejneli, përfaqësuese e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese.
Kryesuesja konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Miratimi i Planit të veprimit nga anëtarët e KKPAK-së.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Pika e dytë

Miratimi i Planit të veprimit nga anëtarët e KKPAK-së.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha, siç jemi në dijeni, kryetari i Komunës e ka bërë një Vendim për anëtarët e Planit të veprimit, ku një anëtare e kemi këtu të pranishme, znj. Irfete, dhe dy anëtarë të tjerë që po mungojnë. Ne kemi punuar mbi Planin e veprimit të vitit të kaluar, u ndërhy aty ku ka pasur nevojë janë ndryshuar ato që janë miratuar dhe realizuar nga Komuna, ato që nuk janë realizuar, disa pika janë ndryshuar dhe për t'ia dhënë përfundimin, ju kemi dërguar në e-mailin e juaj të gjithë anëtarëve të Komitetit, që ta shikoni ku ka nevojë për ndërhyrje dhe plotësimë dhe komentet e juaja me u marrë parasysh.

Ramadan Salihu tha këtë plan e kam lexuar, është ai i mëhershmi, në fakt në parim janë ato pika, s'ka çka shtohet as edhe çka mungohet, por është i papërfillshëm sa i përket përbajtjes, sa i përket metodologjisë. Metodologja është dashur komplet tjetër, se këtë e ka shkruar një person, autorësia e këtij PV është "Hendikos", përpiluesi nuk është që i ka marrë sugjerimet e pjesëmarrësve, por e ka shkruar si ja ka marr mendja dhe ashtu ka kaluar. Ato pikat sugjesteive nuk do të janë pjesë të planit të evaluohet kosto, të bëhet llogaritja, ato janë para se mu bërë plani, plani duhet të dalë me projeksione të qarta duhet të gjitha kostot me qenë të qarta në plan, sepse nëse dërgohet në Kuvend të Komunës ky plan prapë jetë invalid, siç ka qenë, dhe mbetet i pakonkretizuar dhe votohet nga asamblistët, ku asgjë nuk ka konkrete për PAK, d.m.th. ajo 50/1 që është, ajo kuota që është pikë bazë e Planit, ajo tash është sankzionuar me Ligjin për shërbyesit civilë, një vit më vonë, që është tash 2019, që është shumë e avancuar, neni 36, paragrafi 1, i cili veç i obligon punëdhënësit që me punësuar PAK dhe saktësishët e përmend këtë koston e paraparë për PAK, koston e paraparë për minoritete, koston e paraparë për femra. Për mua është një lajm i mirë që po dëgjoj se Komuna është iniciatore e këtij Plani të veprimit 2021-2023, që përpara nuk ka qenë, ka qenë "Hendikos" initiator, kjo është një involvimi konkret dhe pozitivë, dhe këtë duhet ta bëjë një njeri profesionist, nuk ka nevojë me u ngutur. Më mirë hiq mos mu bë një Plan se mos me pas asgjë konkrete, Plani është i punuar shumë dobët.

Premtime Preniqi kërkoi nga zotëri Ramadani në këtë kornizë, faktikisht në kuadër të Planit me shtuar ose me larguar çka mendon dhe me bërë një përbledhje, me na e dërguar me e-mail.

Ramadan Salihu tha se në Plan nuk shkruhet dëshirë, në Plan të veprimit shkruhet mbi baza ligjore. Udhërrëfyesi që e kam bërë unë është i mbështetur në parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e PAK, d.m.th. krejt çka është dashtë me përfshi për PAK -ra është dashtë me marrë prej këtij udhërrëfyesi që e kemi miratuar ne në fillim të kësaj dhe që janë të suplementuara qartë.

Premtime Preniqi tha te kosto është fakt se ndryshon çmimi zakonisht kur janë 3-vjeçare, te kosto më shumë po më intereson ndoshta te kjo pjesa e aktivitetit me u bërë diçka që realizohet.

Irfete Zejneli u shpreh, zotëri Ramadan, nevojat e juaja nuk mund t'i kuptojmë më mirë seç i kuptioni ju, sado që të jemi profesionistë në fushat tona, ju i kuptioni shumë më qartë, andaj është mirë me i paraqitur ato e ne bëjmë përpjekje sa më shumë me i realizuar këto kërkesat e juaja.

Ramadan Salihu tha se këtë pjesën që po e ceku mund ta konkretizojmë dhe ta dërgojmë në Kuvendin e Komunës, d.m.th. nuk ka, evaluohet kosto, kjo është shaka, duhet kosto e qartë, edhe nëse nuk është e saktë është një mendim i një profesionisti.

Plani duhet me qenë serioz, të duket se e ka krijuar Komuna, po ashtu e kemi përpilimin e i data bazës për PAK-ra, data baza nuk bëhet, statistika, evidencia mundesh me bërë vetëm kërkon nga Ministria e Mirëqenies Sociale me ju dërguar linkun ku ka PAK-ra në Kosovë dhe hapet evidencia ndërsa data bazë nuk bëhet, data bazë bëjnë vetëm organet e specializuara që i kanë për veti jo për qytetar, kështu që këtu kemi shumë pa profesionalizëm, këtu duhet të ketë persona ekspertë për përpilimin e Planit të veprimit.

Premtime Preniqi theksoi se ne si Komunë e kemi të pamundur me marrë ndonjë ekspert a, andaj po mendoj, meqë ke profesionalizëm në këtë drejtim zotëri Ramadan, me na ndihmuar, ndihmën tënde e presim, dhe me na dërguar me e-mail dhe të përpinqemi që ta bëjmë një dokument të mirëfilltë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se ideja ka qenë që anëtarët e Komitetit me qenë të njoftuar dhe me dhënë sugjerime secili anëtarë i secilës shoqatë nga e cila vjen.

Ramadan Salihu tha ne nuk jemi ekspertë, nuk jemi njerëz që hartojmë dokumente, mua po më intereson që ky Plan të bëhet mirë, me qenë i pranueshëm nga baza, dhe me qenë një dokumente i qartë i hartuar nga ekspertët.

Irfete Zejneli tha se qëllimi është që prej komunitetit tuaj me i paraqitur si kërkesa se cilat janë nevojat e juaja, sa i përket çështjes së ekspertëve, mendoj se Komuna ka ekspertë të fushave të ndryshme, andaj ata i shqyrtojnë çdo kërkesë tuajën që e kemi. Po kërkoj me i paraqitur nevojat të cilat ekzistojnë. Ne 50% i dimë cilat janë nevojat tuaja, që janë shumë pak të realizuara, e ka edhe që nuk i dimë, e kjo është ndihmesë për neve nëse na tregoni për komunitetin e juaj për nevojat që i keni, pastaj ne hulumtojmë si Komunë se cili është eksperti për atë nevojë që e keni paraqitur.

Premtime Preniqi tha se e vëmja mundësi është, ne p.sh. si grup së bashku me Komitetin, me bërë ndryshimet që mendoni, dhe unë jam pranë atyre ndryshimeve të juaja, me e caktuar një takim me secilën organizatë që merret me PAK me iu dërguar Planin dhe me i marrë komentet, kërkesat e tyre që i kanë lidhur me Planin, mirëpo pa e bërë një përbledhje të përgjithshme nuk mundemi me realizuar, andaj kërkoj nga zotëri Ramadani të bëj një intervenim në Plan, pastaj shkojmë në organizata dhe i konsultojmë.

Ramadan Salihu u shpreh i pajtimit me idenë e koleges, duke thënë se ne e përgatisim së bashku dhe iu tregojmë a pajtoheni, le të pajtohen ata, unë jam dakord, po më pëlqen ideja se lidhesh me komunitetin.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, kërkoi të mbetet ashtu siç po sugjeron zotëri Ramadani, të konsultohemi me dy-tri OJQ dhe të përfundohet.

Irfete Zejneli tha se do tē ishte mirë që me ua dërguar me e-mail dhe me iu thënë se cilat janë kérkesat, nevojat e juaja shtesë tē OJQ-ve.

Ramadan Salihu shprehi shqetësimin pér mos pjesëmarrjen e anëtarëve tē Komitetit në takime, ku prej 7 anëtarë, munden me munguar 1-2 anëtarë me arsyetim, por kështu si po ndodhështë jo serioze. Ju lutem si kolegë, që tē diskutoni lidhur me këtë çështje me anëtarët e Komitetit.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha këtë çështje e kam potencuar disa herë, por përgjigjja nga Premtimja ka qenë se vijnë apo nuk vijnë, Komuna nuk mund tē zgjedhë anëtarë tē ri.

Premtim Preniqi tha se komiteti funksionon prej 5 anëtarëve, kështu me qenë në dijeni që nuk vijnë dhe nuk mban shpresë te ajo pjesë, por nëse nuk iu konvenon atë mund ta ndryshojmë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, sugjeroi që Premtimja t'i thërret anëtarët, eshtë më zyrtare me telefon, e tē bisedon.

Premtim Preniqi tha grupi që jemi takuar, jemi nisur prej asaj me qenë aktivitetet, a janë të realizueshme, a janë realizuar, i kemi shikuar, mandej kemi parë edhe në terren çka ka tē zhvilluara bashkë me Irfeten.

Irfete Zejneli tha se infrastruktura që ka tē bëjë me profesionin tim eshtë shumë pak e realizueshme, ka nevojë, zotëri Ramadani e ceku që duhet me u caktuar kostoja. Sado që ta caktosh koston në Komunën e Prishtinës, ke nevojë pér pjerrina, pér ashensorë, pér PAK, ke sa tē duash nevojë mi pasur edhe 1 milion euro tē ndara ka nevojë se ka shumë kérkesa.

Premtim Preniqi u shpreh se unë jam më shumë e interesuar me dal një dokument sa më i mirë e sa më i realizueshëm, që tē paktën nesër kur tē marrë dikush në dorë me thënë se kjo ka mundur me u realizuar, pse nuk po realizohet.

Jeton Canhasi u shpreh se kur ta lexosh këtë Plan veprimi tē duket si fontanë dëshirash, pa asgjë konkrete, e dikush mund tē thotë ka qenë edhe vitin e kaluar, vetëm e ka përshkruar, nuk ka shtuar asgjë tjeter, prej këtyre pikave që kam lexua janë çështjet shumë tē qarta, por sa i përket PAK shumë pak eshtë përfshirë. Sa i përket Planit tē veprimit mendoj se duhet paraqitur më në detal, d.m.th. detal ishte sa i përket intervenimeve, që e ceku kolegia Irfete, me i ditë konkretisht pikat, qyteti si qytet ku janë pikat që duhet me intervenuar. Sa u përket ashensorëve, para luftës eshtë lejuar ndërtimi i ndërtesave deri 4 - 5 kate pa ashensor, shtrohet pyetja se çka me u bërë tē moshuarve, invalidëve etj.?

Mendimi im si ekspert, eshtë që këto ndërtesa që janë shfrytëzuar me mbi ndërtim pa leje, me i rrënuar mbindërtimet dhe e kisha angazhuar BVI-në që aty me shtuar katin dhe me i shitur ato banesa dhe mu bërë lifti, se gjithmonë do tē kemi telashe me tē moshuar, invalidë etj. Unë do tē angazhohem, janë disa pika që mundem me kontribuar, mirëpo e kam një vërejtje, këtu nuk janë cekur numrat, kishte qenë mirë me u cekur numrat 1,2,3që nëse dëshiron me u thirre, thirresh në numra. Po ashtu, kam vërejte aty ku thuhet "të rritet eficiencia e policisë", si me e rritur.

Premtim Preniqi tha se ne e kemi pasur diskutabile çështjen e eficiencës së policisë, këtu e kemi pasur fjalën policia, se këtu "Prishtina Parking" ku po shkruan, inspeksioni komunal së bashku me polisinë, d.m.th. bashkëpunimi me polisinë këto parkingjet që zihen pér PAK me i dënuar kur tē bëhet "Prishtina Parking".

Jeton Canhasi tha se ne e kemi pasur këtë bisede edhe më herët. Unë pata thënë se nëse ke fëmijë me aftësi të kufizuara, Komuna me dhënë një shenjë që e vendos në vetur dhe kryhet kjo punë. Aty ku është shenja e parkingut, aty qitet edhe numri i telefonit, lajmëro se tu ka zënë parkingu, ai e lajmëron, ka edhe të tjeter mundësi, fotografoje, dërgoje në polici dhe policia e dënon etj.

Premtime Preniqi pyeti se a do të hyjë kjo në sistem, sepse ne nuk e kemi pasur këtë informatë.

Jeton Canhasi parashtroi pyetjen se data-baza a qëndron për të gjithë PAK, Komuna a e ka. Premtime Preniqi u përgjigj jo, nuk ekziston, i ka vetëm ata që marrin shërbime.

Irfete Zenelaj dha sqarime, duke thënë se evidentimin e bënë Drejtoria e Mirëqenies Sociale, e ka obligim, në kuadër të Komunës është.

Premtime Preniqi bëri të ditur se në fund ky Plan i veprimit u dorëzohet nëpër drejtori, drejtorët e shohin cila pjesë ju takon atyre dhe pastaj ato pjesë me i futur në planet e tyre të përgjithshme. Plani mund të përmirësohet në ndërkokë.

Ramadan Salihu bëri të ditur se data-bazë nuk ka, vetëm Ministria e Mirëqenies Sociale, Komuna nuk ka nevojë për data bazë, kjo është gabim.

Premtime Preniqi u shpreh se presë nga ju që t'i dërgoni komentet e juaja dhe vazhdojmë tutje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demoll - Mustafa

